



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.02.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4756/22, për zyrtarin z. Esat Xani, Ekspert i GIS në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Esat Xani, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi i jashtëm, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit sipas të cilit, z. Xani, në cilësinë e zyrtarit/ekspertit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit me rastin e aprovimit lëndës me numër 04/1604/22, në të cilën lëndë ka qenë e përfshirë kompania "Geohorizont" SH.P.K., pronare e të cilës është znj. Besime Xani, bashkëshortja e z. Esat Xani.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin z. Xani lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02-5008/22).

Më pastaj, Agjencia ka caktuar një takim me z. Xani, me ç'rast e ka njoftuar me pretendimet e ngritura lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, si dhe ka dëgjuar sqarimet e tij lidhur me pretendimet në fjalë. Ndër të tjera ai ka sqaruar se në lëndën me numër si më lartë, kompania "Geohorizont" nuk ka qenë e përfshirë në asnjë mënyrë, për çka edhe ka prezantuar dokumentacionin përkatës .



Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-02/114/23) ka kërkuar dokumentacione dhe informacione shtesë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit dhe informacioneve të siguruar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (DPKI-06-02/114-1/23), pastaj dispozitave ligjore përkatëse si dhe sqarimeve nga pala, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka gjetur që z. Esat Xani të jetë përfshirë në vendimmarrje në konflikt interesi, andaj, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit, për faktin se:

Në sqarimet e dhëna nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, në mes të tjerash është theksuar se në bazë të shkresave të lëndës me numër protokolli 04/1604/22, kompania “Geohorizont” nuk ka asnjë përfshirje në këtë lëndë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka shqyrtuar shkresat e lëndës në fjalë të cilat i ka marrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, sipas të cilave kompani “Geohorizont”, nuk është e përfshirë në asnjë mënyrë në lëndën e pretenduar.

Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ashtu siç është përcaktuar me neni 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht, “*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.*”

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buloshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

